

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova
Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo

Nr. Br./No. 363/09/20 Nr.faq./Br.str./No.pg. 4
Data/Datum/Date 14.03.2020
PRISHINE - PRISTINA - PRISTINA



AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E
KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 02 Nr. 20019
U. _____ Br. _____
Nr. i faq. 4 Data: 11/09
Br. str. _____ Datum: _____
KAMENICË/A 2020



Komuna Kamenicë - Opština Kamenice - Municipality of Kamenicë

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT – RENOVIMI I VARREZAVE TË DESHMOREVE DHE
MARTIRËVE NË KOMUNËN E KAMENICËS

Palët Nënshkruese

1. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, përfaqësuar nga Drejtori i Agjencisë z. Bislim Zogaj

dhe
2. Komuna e Kamenicës e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Qëndron Kastrati.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është financimi i projektit “Renovimi i Varrezave të Dëshmorëve dhe Martirëve në Komunën e Kamenicës” dhe përcaktimi i obligimeve të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Komunës së Kamenicës për realizimin e këtij projekti.

Neni 2

Vlera e projektit

Projekti “Renovimi i Varrezave të Dëshmorëve dhe Martirëve në Komunën e Kamenicës” ka vlerë paralogaritare në shumë prej 70,000.00 € (shtatëdhjetë mijë euro).

Neni 3

Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

3.1 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës i zoton mjetet financiare në shumë prej 55,000.00 € për projektin nga neni 2 i kësaj Marrëveshje, parashihet e tërë vlera për në vitin 2020.

3.2 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës merr përsipër që projektin “Renovimi i Varrezave të Dëshmorëve dhe Martirëve në Komunën e Kamenicës” ta realizoj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi me të cilat është rregulluar kjo çështje.

3.3 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës cakton menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.

3.4 Menaxheri i projektit, organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

3.6 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës e obligon operatorin ta vendos në punishte tabelën informuese (Pano) standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

3.7 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që projekti të përfundoj gjatë vitit buxhetor - 2020. Në rast se gjatë këtij viti, me fajet e AMKMK – së, nuk kryhet ky projekt, të gjitha obligimet për përfundim të tij mbesin në përgjegjësi të Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

3.8 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës do ta njoftoj Komunën për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani një mujor deri në përfundimin e projektit.

Neni 4

Obligimet e Komunës

4.1 Komuna e Kamenicës merr përsipër të bashkëfinancoj në këtë projekt në shumë prej 15,000.00 € (pesëmbëdhjetë mijë euro) me buxhetin e vitit 2020.

4.2 Komuna është e obliguar që brenda 5 ditëve nga pranimi i marrëveshjes së mirëkuptimit të nënshkruar dhe protokolluar, të sjellë në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, projektin zbatues, tërë dokumentacionin e nevojshëm për këtë projekt si dhe siguron vendin – hapësirën në mënyrë që të mos ketë pengesa në realizim.

4.3 Komuna e Kamenicës do të caktoj një zyrtar profesional për përcjellje të realizimit të projektit nga kjo marrëveshje.

Neni 5
Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

5.1 Me pëlqimin paraprak të Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimi e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës, kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

5.2 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se komuna nuk i përmbushë obligimet e veta nga kjo marrëveshje.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim.

Neni 8
Pronësia e projektit

8.1 Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik ky projekt nga kjo marrëveshje do të kaloj me automatizëm në pronësi të Komunës së Kamernicës.

8.2 Ky projekt regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë fizike dhe elektronike në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 7
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në katër kopje, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që marrëveshje e mirëkuptimit të hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

AMKMK

BZ

Bislim Zogaj, Drejtor



Komuna e Kamenicës

Qëndron Kastrati, Kryetar

